

SEKSIONI 1: DEKLARIME TE KLIENTIT PER "SIGURIMIN E JETES"

Per Kredi Konsumatore

1.1 Pasi u njoha nga lute Pay me ofertat e sigurimit dhe shoqëritë e sigurimit, që ofrojnë këto produkte, deklaroj me vullnetin tim te lirë dhe te plotë, nëpërmjet kësaj kërkesë se pranoj që të kryej "Sigurimin e Jetes për Hua" pranë Siguruesit të zgjedhur prej meje, me qëllim sigurimin e kredisë pranë luteCredit Albania Sh.a.

1.2 Deklaroj se jam njohur dhe jam plotesisht dakort me kushtet dhe afatet e paraqitura në Paketën e Sigurimit te Jetes, te paraqitur si me poshte. Ne perputhje me percaktimin ne formularin e polices se sigurimit dhe parashikimet e Kushteve te Pergjithshme te sigurimit, kuptoj dhe pranoj qe ngjarje sigurimi do te jete: *«Ngjarja e Sigurimit do te thote Humbja e jetes se te siguruarit per shkaqe aksidentale apo natyrore si dhe paaftesia e perhershme e plote brenda periudhes se sigurimit, ndodhja e te ciles sjell detyrimin e Siguruesit per te paguar perfitimin sipas kushteve te kontrates. Përfitimi i pagueshëm do të jetë shuma e mbetur e huasë në datën e ndodhjes së ngjarjes së sigurimit.»*

1.3 Deklaroj dhe bie dakord se në kuadër të sigurimit të pagesës së kredisë, Përfituesi i policës së sigurimit është "luteCredit Albania Sh.a. dhe se çdo perfitim sipas sigurimit të jetës do t'i paguhet luteCredit Albania Sh.a.

1.4 Autorizoj lutePay shpk te pajise Siguruesin e zgjedhur prej meje me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për sigurimin që lidhet me Kredine e marre prane lutecredit Albania Sha. Ky autorizim jepet për një afat të pacaktuar dhe përfshin të drejtën e lutePay në cilësinë e agjentit, që të kryejë rinovimin e policës së sigurimit, pa qenë nevoja për autorizim tjetër nga ana ime, për sa kohë që sigurimi lidhet me afatet e huasë. Për të revokuar këtë autorizim, detyrohem të njoftoj me shkrim lutePay, 30 ditë përpara përfundimit të afatit të policës.

1.5. Jam njohur me deklaratën e privatesise te Siguruesit dhe autorizoj Siguruesin të mbledhë dhe përpunojë të dhënat dhe informacionin personal i cili nevojitet për administrimin e kontratës së sigurimit, për dhënien e shërbimeve ndaj të siguruarit dhe përfituesit përfshirë trajtimin e dëmit, për ofrimin e produkteve apo shërbimeve të reja, bazuar në legjislacionin përkatës të mbrojtjes së të dhënave personale (Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale") si dhe transferimin e të dhënave personale tek të tretë për qëllime të sigurimit të cilët garantojnë gjithashtu mbrojtjen e të dhënave personale.

1.6 Jam i informuar që nuk ngarkohem me komisione shtesë për këto produkte sigurimi.

1.7. Jam informuar se në rast të mbylljes të parakohshme të kredise, mbaron mbulimi në sigurim dhe primi i sigurimit nuk është i rimbursueshem përveç se kur kredia mbyllet brenda 14 ditësh nga marrja e saj.

Shenim: *IutePay shpk ofron vetëm produkte nga shoqëritë e sigurimit me të cilat bashkëpunon, të cilat sipas link me poshtë:*

IutePay nuk keshillon apo rekomandon përzgjedhjen e shoqërive të sigurimit për produktet që ofrojnë. Në mund t'ju bëjmë disa pyetje për të kuptuar kërkesën tuaj vetëm për qëllim të dhënies së informacionit mbi produktet e përzgjedhura nga klienti, por zgjedhja është teresisht në vullnetin e lire të klientit.

Lutem, lexoni me kujdes dokumentat dhe informacionin e vene në dispozicion për t'u siguruar që zgjedhja i përshtatet nevojave tuaja.

SEKSIONI 2: INFORMACIONE TE PERGJITHSHME TE SIGURIMIT TE JETES SE DEBITORIT

“SIGURUESI”: person juridik i regjistruar rregullisht pranë Qendres Kombetare të Biznesit dhe licensuar si Shoqëri Sigurimi Jete nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

IUTEPAY SHPK / AGJENTI

Adresa: Rruga “Andon Z. Cajupi”, Pallati Nr.3, Hyrja Nr. 2, Kati Nr.3, Tiranë

MBULIMI NE SIGURIM

Siguruesi do t'i paguajë policembajtesit/ perfituesit Perfitimin e Pagueshem ne rast te ndodhjes se ngjarjes se sigurimit.

Në përputhje me percaktimin në policen e sigurimit dhe në Kushtet e Pergjitheshme të sigurimit, ngjarje sigurimi do të jete nje nga vijueset :

- « Humbja e Jetes » ose / « Humbja aksidentale e jetes » ose/

- « Paaftesia e Perhereshme Totale si pasoje e aksidentit »

'Humbja e Jetës së të Siguruarit' do te quhet Humbja e jetës së të siguruarit brenda periudhës të sigurimit.

Paaftesia e Plote e Perhershme si rrjedhoje e nje aksidenti eshte paaftesia e shkaktuar nga nje aksident, i cili ndodh brenda periudhes te sigurimit, qe e ndalon plotesisht te siguruarin per t'u marre me cdo veprimtari ekonomike ose pune te cdo loji dhe qe pas perfundimit te nje periudhe 52 javore nga fillimi i paaftesise si pasoje e nje aksidenti rezulton:

- humbja totale dhe e pariparueshme e shikimit ne te dy syte;
- humbja totale fizike ose funksionale e dy ose me shume gjymtyreve se bashku;
- humbja e plote e shikimit ne nje sy dhe humbja e nje gjymtyre se bashku;
- paraliza e plote (Humbja ose demtimi i funksioneve motore dhe ndjesore.)

"Paaftesi e Plote e Perhershme per pune si me siper duhet te vertetohet nga nje autoritet mjekesor kompetent.

'Aksident'. Një ngjarje e papritur dhe e paparashikuar që ndodh pa vullnetin e të siguruarit, e identifikueshme për sa i përket kohës dhe vendit të ndodhjes, që ka impakt trupor të drejtpërdrejtë të jashtëm dhe të dhunshëm mbi të siguruarin.

'Humbja Aksidentale e Jetës'. Humbja e jetës të të siguruarit si rrjedhojë e një Aksidenti që ndodh brenda periudhës të sigurimit, humbje jete që ndodh brenda 12 muajsh nga data e këtij Aksidenti.

TERRITORI I MBULIMIT

Rreziku i Humbjes te jetes eshte i mbuluar pa asnje kufizim territorial , ndersa rreziku i aksidenteve pa pasoje Humbjen e jetes, eshte i mbuluar vetem brenda territorit te Republikes se Shqiperise

RREZIQE TE PERJASHTUARA

Ky sigurim nuk mbulon vdekjen e te Siguruarit qe eshte rrjedhoje direkte ose indirekte e pjesemarrjes se te Siguruarit ne veprimtari te paligjshme apo kriminale, akte kriminale e keqedashese nga persona me te cilet i Siguruari ka konflikte te mepareshme, si dhe sulme apo veprime e kunderveprime te dhunshme te provokuara me te tretet, pervec kur i Siguruari vepron ne kushtet e nevojës ekstreme për vetembrojtje, pjesemarrjes se trashëgimtareve ligjore, ortakeve ose perfituesit ne akte kundër interesit të të Siguruarit, ose kryerja e sigurimit ne rrethana te paramenduara qe favorizojne pagesen e demit, luftës, pushtimit, akteve kriminale

(pavarësisht nëse lufta është shpallur ose jo), lufta civile, revolucionit, rebelimit, sekuestrimit të personit, trazirave, krimit të organizuar, përdorimit të armëve ose paisjeve të luftës, akteve terroriste, agresionit, praktikimit të sporteve të rrezikshme apo parachutizmi, ngjitjeve malore, fluturimit me avion pa motor, zhytjeve në ujë, garave sportive motorrike apo drejtimi i mjeteve tokësore, ujore apo ajrore pa licencë.

Udhëtimin e siguruarit me çdo mjet fluturimi, përveç se, kur udhëton si pasagjer (dhe jo si anetar i ekipazhit) në një mjet fluturimi që është i autorizuar për transportin e pasagjerëve; aksidentit nga shpërthimet dhe radiacioni i energjisë bërthamore, përmbajtjet, termetet, zhvendosjet e tokës dhe shpërthimet vullkanike; vetëvrasjes dhe tentativës për vetëvrasje nëse ndodh në dy vitet e para të hyrjes në fuqi të kontratës së sigurimit ose të riaktivizimit të mundshëm të sigurimit;

Çdo lloj defekti fizik apo mendor parëzistues, sëmundjeve të njohura të trajtuara apo të diagnostikuara përpara marrjes së sigurimit ose sëmundjeve të lidhura me to, përveçse kur është deklaruar me shkrim nga i Siguruari dhe është pranuar shprehimisht me shkrim nga Siguruesi; Influenca dhe përdorimi i alkoolit (dehja), drogës apo substancave të tjera narkotike, përdorimit me tepri të psikofarmaceutikëve, ilaçeve apo halucinantëve, si dhe pasojave që rrjedhin prej tyre. Sëmundje veneriane, sëmundje seksuale të transmetueshme, sëmundje si pasojë e virusit HIV. Në rast vdekjeje, Përfituesi nuk do të paguhet nëse kufoma nuk gjendet apo është e paidentifikueshme.

Individë që nuk sigurohen

Siguruesi nuk ofron mbulim në sigurim për:

- individë që vuajnë nga alkoolizmi, narkotizmi, sëmundje mendore, paranoia, sindroma organiko-cerebrale;
- individë që kanë nevojë për kujdes të përhershëm;
- individë mbi 65 vjeç;
- individë më të rinj se 18 vjeç

HAPJA E PRAKTIKAVE TË DËMEVE

Njoftimi i rastit të ngjarjes së sigurimit bëhet sipas formularit përkatës dhe bëhet:

- ✓ me shkresë në adresën zyrtare të Shoqërisë së Sigurimit
- ✓ në mënyrë elektronike në email-in zyrtar të Shoqërisë së Sigurimit

Praktika e dëmit hapet në momentin e njoftimit të rastit të sigurimit nga:

- ✓ policembajtësi,

- ✓ përfituesi, apo
- ✓ i siguruari.

AFATI I SHQYRTIMIT TE PRAKTIKES SE DEMIT

Praktika e demit shqyrtohet brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të dokumentit të fundit nga përfituesi, apo i siguruari.

Ky afat shtyhet deri në dorëzimin e dokumentit shtese të fundit të kërkuar nga shoqëria e sigurimit;

Periudha e trajtimit të rastit të sigurimit do të jetë e ndryshme nëse kjo gjë është parashikuar në kushtet e kontratës së sigurimit.

Afati i shqyrtimit të praktikës shtyhet deri në vërtetimin e shkaqeve apo nxjerrjes së paaftësisë për rastet e:

- ✓ e paaftësisë së përhershme, kur nuk është e mundur të përcaktohet brenda një kohe të shkurtër shkalla e paaftësisë;
- ✓ vdekjes, kur rrethanat e ndodhjes së dëmit janë të paqarta dhe kërkojnë një periudhë të gjatë për tu vërtetuar nga organet kompetente.

DOKUMENTACIONI I NEVOJSHEM PER PLOTESIMIN E PRAKTIKAVE TE DEMEVE

Njoftimi i rastit të sigurimit sipas formularit përkatës.

- Polica e Sigurimit ose certifikata e sigurimit
- Skeda e vdekjes dhe certifikata e vdekjes (kur i siguruari ka humbur jeten
- Dokumentacioni mjekësor (epikriza mjekësore, kopje të karteles mjekësore, etj) sipas rastit të sigurimit që mbulon polica e sigurimit;
- Dokumentacioni nga organet e policisë dhe ato të drejtësisë (gjykatë; prokurori) sipas rastit të sigurimit;
- Flete-Drejtimi për në KEMP dhe Vendimin e Komisionit të caktimit të paaftësisë në punë KMCAAP (për rastet e paaftësisë të plote të përhershme nga Aksidenti).
- Çdo dokument tjetër sipas polices së sigurimit dhe të kërkuar nga shoqëria e sigurimit.

Për më tepër në lidhje me procedurën në rast dëmi, informacioni gjendet në faqen zyrtare të shoqërisë së sigurimit perzgjedhur nga i siguruari.

ANKESA:

Per cdo ankese lidhur me procesin e sigurimit mund te drejtoheni ne faqen zyrtare te shoqerise se sigurimit perzgjedhur nga ju, sipas menyrove te kontaktit te publikuara ne faqen ANKESA.

Ne rast se keni pyetje apo paqartesi te tjera, lutepay sha mund t'ju vije ne ndihme duke kontaktuar sipas menyrove te kontaktit : <https://iute.al/kontakt/>

PERFUNDIMI I KONTRATES SE SIGURIMIT

Kontrata e sigurimit do te konsiderohet e perfunduar ne rast se ndodh nje nga ngjarjet e meposhtme: huaja eshte shlyer; huaja eshte transferuar tek nje Debitor tjetër jo i perfshire ne kete police sigurimi; ka ndodhur ngjarja e sigurimit dhe primi i sigurimit nuk eshte paguar; Siguruesi i ka paguar Perfituesit shumen e demshperblimit;

CEDIMI, PENGU, BLOKIMI DHE LESHIMI I DUBLIKATES

I siguruari nuk mund ta cedoje policën e sigurimit te një palë e tretë si garanci, ose nuk mund ta bllokojë shumën e sigurimit në emër të një personi të tretë.

Nese polica origjinale priset, grisët ose behët e palexueshme, i Siguruari duhet te pajiset me nje police te re sigurimi me te njejta te dhena si polica e mepareshme.

DISPOZITA TE TJERA

Taksat dhe tatimet, nese do te ekzistojne do te jene ne ngarkim te te Siguararit. Pavarësisht kësaj, veprimtaria e shërbimeve të sigurimit dhe risigurimit janë furnizime të përjashtuara nga TVSH-ja bazuar në nenin 53, pika a. ligji nr. 92/2014 Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në RSH. (<https://www.tatime.gov.al/c/6/71/tatimi-mbi-vleren-e-shtuar>). Primet e sigurimit për produktet e jetës janë të përjashtuara nga taksa mbi primet e shkruara bazuar në pikën 10, neni 3 , Ligj Nr. 9975, date 28.7.2008, PËR TAKSAT KOMBËTARE. (<https://www.tatime.gov.al/c/6/72/taksat-kombetare>)

Mosmareveshjet qe mund te lindin nga kjo kontrate, nese nuk zgjidhen me mirekuptim, do te zgjidhen ne rruge gjyqesore.

Per cka nuk eshte parashikuar ne dispozitat e ketyre kushteve te pergjithshme do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Primi i sigurimit të jetës, është shuma për t'u paguar nga klienti në kuadër të një marrëveshje të vecantë me qëllim sigurimin e jetës së klientit. Primi i sigurimit të jetës do të paguhet nga klienti në rastet kur sigurimi i jetës pranohet dhe kërkohet nga kredimarrësi sipas kërkesës me shkrim.

AFATET E PAGESES SE PRIMIT DHE PASOJAT E MOSPAGIMIT:

Polica hyn në fuqi me pagesën e primit.

Primi i sigurimit paguhet paraprakisht si prim i vetëm për të gjithë kohëzgjatjen e periudhës së sigurimit. I siguruari detyrohet t'i paguajë siguruesit primin e sigurimit në afatet e caktuara në police.

Nëse primi nuk paguhet brenda afatit kohor të përcaktuar më sipër, atëhere kjo policë nuk ka vlerë dhe mbulimi i dhënë prej saj përfundon prej fillimit (ab initio).

“Përfitimi i pagueshëm” është shuma e principalit të mbetur sipas tabelës së amortizimit të kredive në datën e ndodhjes së ngjarjes Politikat e privatësisë të shoqërisë së sigurimit të perzgjedhur nga ju i gjeni në faqen zyrtare perkatese, seksioni “Politikat e privatesise”

Nenshkrimi

(emer, mbiemer, firme)